



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

H-039/01-28058/pj, më 28 DEC 2021

Në bazë të neneve 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/15, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për caktimin e personave përgjegjës për kontrollimin e zbatimit të masave kundër COVID-19.
- II. Anëtarët e cekur si në pikën I të këtij vendimi janë:

Objekti i vjetër i Komunës:

1. Ramadan Osmani, zyrtar i sektorit të Gjendjes Civile;
2. Nefi Krasniqi, shef i Qendrës për Shërbim me Qytetarë;

Inspekcioni:

1. Ermira Berisha, zyrtare e Drejtorisë së Inspekcionit;

Drejtoria e Arsimit:

1. Lulzim Vrapca, shef i sektorit të Arsimit;

Objekti i ri i Komunës:

1. Fitore Rizani, zyrtare e Drejtorisë së Kadastrit;
2. Fatmir Gashi, zyrtar i Drejtorisë së Urbanizmit;
3. Afërdita Krasniqi, zyrtare e Drejtorisë së Shëndetësisë.

III. Detyrat dhe punët e anëtarëve të cekur si në pikën I të këtij vendimi, janë kontrollimi i zbatimit të masave kundër COVID-19, të përcaktuara sipas nenit 6 dhe 7 “Mbrojtja dhe siguria në punë” të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 nr. 02/46 i datës 30.11.2021, respektivisht posedimit të njëjës nga dëshmitë për hyrje në ambiente të punës për të gjithë punonjësit e Komunës së Prishtinës, të cekura si në vijim:

1. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë (me dy doza) kundër COVID-19;
2. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin me një dozë, jo më e vjetër se katër javë;
3. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin me një dozë bashkë me dëshminë se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë).

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të ekipit përgjegjës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Kabinetit të Kryetarit dhe
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

